

---

**RREGULLORE NR. 2003/19**

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS  
MBI BIBLIOTEKAT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 8.1. (a), 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh njoftimet zyrtare të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 11 prill 2003 lidhur me Ligjin mbi bibliotekat i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 4 prill 2003,

Me anë të të kësaj shpall Ligjin mbi bibliotekat që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Ligji nr. 2003/6), i cili hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

a) Termi “kombëtare” kudo që paraqitet në Ligj fshihet dhe të gjitha emërtimet që përmbajnë këtë term formulohen duke përdorur termin “Kosova” dhe

b) Tekstet e gjuhës shqipe dhe serbe duhet të jenë njësoj autentike, ndërsa neni 43.2 fshihet.

Këto ndryshime duhet të pasqyrohen në tekstin përfundimtar të ligjit.

Nënshkruar sot, më 23 qershor 2003.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

## **LIGJI PËR BIBLIOTEKAT**

Kuvendi i Kosovës ,

Duke u bazuar në Rregulloren nr.2001/9 të dt. 15 majit 2001 për Komizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, nenet 9.1.26.(a) , 5.1 (e),

Duke pasur parasysh nevojën e vendosjes së një sistemi modern të bibliotekarisë i cili do t'u mundësojë shfrytëzuesve qasje të lirë, dhe të avancuar në fitimin e njohurive dhe informacioneve të reja:

miraton ligjin vijues:

### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

- 1.1. Ky Ligj përcakton parimet dhe normat themelore për veprimtarinë bibliotekare dhe për organizimin e mirëvajtjen e bibliotekave.
- 1.2. Ky Ligj u referohet të gjitha bibliotekave që ofrojnë shërbime bibliotekare publike, pavarësisht nga forma e pronës dhe përkatësia institucionale e tyre.

##### **Neni 2**

- 2.1. Biblioteka është institucion kulturor, edukues e informues, që grumbullon, pasuron, përpunon, mirëmban dhe ruan koleksionet e veta nga fushat e ndryshme të krijimtarisë dhe të veprimtarisë intelektuale, të përvojës e të opinionit njerëzor me qëllim që t'i bëjë të njohura dhe t'ua vë në dispozicion shfrytëzuesve për t'i lexuar, hulumtuar e studiuar dhe për t'i lënë në trashëgimi gjeneratave të ardhshme.
- 2.2. Biblioteka shërben për përhapjen e njohurive, kulturës, arsimit, shkencës dhe u ofron shfrytëzuesve mundësi për edukim, informacione dhe zhvillim personal kulturor, profesional, krijues, komunikues dhe qytetar.
- 2.3 Biblioteka u mundëson qytetarëve realizimin e të drejtës për qasje të lirë në bibliotekë, të drejtën e kërkimit dhe të marrjes së informacioneve e të njohurive nga koleksionet bibliotekare dhe burimet tjera në çfarëdo forme, si dhe nxitë interesimin dhe shprehinë e qytetarëve për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive dhe mirëqenje shpirtërore.

- 2.4. Biblioteka nxitë dhe ndihmon afirmimin e vlerave demokratike dhe përpjekjet për shoqëri të hapur e tolerante dhe për komunikimin universal të fryteve intelektuale.
- 2.5. Biblioteka siguron mundësi të barabarta për shfrytëzuesit në ofrimin dhe përdorimin e informacioneve e shërbimeve bibliotekare.
- 2.6. Në bashkësitë me më shumë gjuhë, kërkesat e pakicave etnike merren parasyshë në kushte të barabarta dhe interesat e tyre kulturore prezantohen në materialet bibliotekare.

### **Neni 3**

Sipas këtij Ligji:

- 3.1. Shfrytëzues është personi të cilit i vihet në shfrytëzim materiali bibliotekar dhe informacionet e shërbimeve bibliotekare që i nevojiten, dhe që biblioteka ka mundësi dhe për detyrë t'ia ofrojë;
- 3.2. Biblioteka të sektorit publik janë bibliotekat e krijuara nga autoriteti publik legjislativ ose ekzekutiv, përkatësisht ato që financohen nga fondet buxhetore ose fondet tjera publike si dhe bibliotekat pranë institucioneve të krijuara nga autoriteti publik legjislativ ose ekzekutiv, përkatësisht që financohen nga fondet buxhetore ose fondet tjera publike.
- 3.3. Bibliotekat publike janë Biblioteka Kombëtare e Kosovës, bibliotekat ndërkomunale, bibliotekat komunale, (të lokaliteteve fshatare ) që vepronë si biblioteka të bashkësisë.
- 3.4. Bibliotekë e veçantë është biblioteka e themeluar pranë institucioneve arsimore, institucioneve kërkimore shkencore, partive politike, organizatave fetare, organizatave joqeveritare, ekonomike etj.
- 3.5. Bibliotekë private është biblioteka në pronësi private, e themeluar për përdorim publik.
- 3.6. Qasje nënkupton të drejtën dhe mundësinë e shfrytëzuesit për hyrje në bibliotekë dhe për të pasur në dispozicion materialet, informacionet e shërbimeve bibliotekare.
- 3.7. Autoriteti që ka në vartësi bibliotekën, është organ ose institucion i pushtetit qendror ose komunal që, në përputhje me dispozitat ligjore, ka në përkatësi institucionale bibliotekën, ose personi tjetër që ka themeluar bibliotekën, qoftë si subjekt më veti, qoftë si njësi në përbërjen e vet;
- 3.8. Ministri përkatëse për bibliotekat e sektorit publik është Ministria për Kulturë, Rinë, dhe Sport ( më tutje: Ministria e Kulturës) kurse për ato universitare, shkollore dhe shkencore është Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (me tutje Ministria e Arsimit)

### **Neni 4**

- 4.1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të themelojë dhe drejtojë bibliotekë, në përputhje me ligjin.

- 4.2. Biblioteka themelohet si institucion i veçantë ose si njësi organizative për shërbime bibliotekare në përbërjen e një subjekti tjetër ligjor publik ose privat.
- 4.3. Biblioteka mund të filloj veprimtarinë nëse i plotëson standardet minimale lidhur me hapësirën fizike dhe mjedisin e bibliotekës, koleksionin fillestar, paisjet dhe personelin bibliotekar, si dhe nëse regjistrohet në Regjistrin e bibliotekave të Ministrisë së Kulturës.
- 4.4. Standardet minimale i cakton Ministria e Kulturës me urdhëresë administrative ose rregullore, në varësi me funksionin e llojin e bibliotekës, si dhe me synimet e zhvillimit të kulturës e të arsimit dhe mundësitë materiale.
- 4.5. Regjistri i bibliotekave është regjistër publik.
- 4.6. Kërkesën për regjistrim, s`bashku me një ekzemplar të rregullores së bibliotekës dhe deklaratën për gatishmerinë e veprimit në përputhje me këtë ligj, e bënë personi që përfaqëson bibliotekën, përkatësisht themeluesin e saj.
- 4.7. Lidhur me kërkesën për regjistrim vendos Divizioni i promovimit-Sektori i bibliotekarisë i Ministrisë së Kulturës jo me vonë se 15 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.
- 4.8. Kundër vendimit të Divizionit të Promovimit – Sektorit të Bibliotekarisë, paraqitësi i kërkesës për regjistrim ka të drejtën e ankesës Ministrisë së Kulturës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
- 4.9. Kundër vendimit të Ministrisë së Kulturës mund të fillojë kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
- 4.10. Me rregullore të veçantë Ministria e Kulturës përcakton me detajishtë kushtet dhe mënyrën e regjistrimit të bibliotekave.

## **Neni 5**

Lidhur me themelimin, statusin ligjor, drejtimin e bibliotekave, mbikëqyrjen administrative e financiare, punësimin, pozitën, përgjegjësitë e mirësjelljen e personelit dhe për çështje tjera që nuk përfshihen me këtë ligj, vlejné dispozitat ligjore për shërbimin publik, nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe.

## **KREU II**

### **RRJETI BIBLIOTEKAR KOMBËTAR**

## **Neni 6**

- 6.1. Çdo bibliotekë është pjesë përbërëse e rrjetit kombëtar bibliotekar me qëllim të zbatimit të njësuar të standardeve, përgatitjes dhe shpërndarjes së bazës së të dhënave dhe begatimit e bashkërenditjes të bashkëpunimit ndërbibliotekar.
- 6.2. Planin strategjik për krijimin e rrjetit bibliotekar kombëtar e harton Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit duke e projektuar në raport me të gjitha

bibliotekat dhe si komponente të rëndësishme të strategjive afatgjata në fushën e kulturës, të sigurimit të informacionit, arsimit dhe edukimit.

- 6.3. Bibliotekat bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacioneve, ideve dhe përvojës; në ndarjen e burimeve, në zhvillimin e koleksioneve, në bashkërendimin e shërbimeve, në shkollimin dhe trajnimin e personelit, në sigurimin e qasjes në burime dhe informacione bibliotekare nëpërmjet të krijimit, mirëmbajtjes dhe pjesëmarrjes në rrjetin elektronik të të gjitha niveleve.
- 6.4. Rrjeti i informacioneve bibliotekare është kompatibil dhe pjesë përbërëse e rrjetit kombëtar të informacionit.
- 6.5. Bibliotekat bashkëpunojnë me institucionet arsimore, shkencore, muzetë, arkivat dhe me institucionet tjera të komunitetit për t'i koordinuar burimet dhe përpjekjet për rritjen e nivelit të shërbimeve për shfrytëzuesit dhe komunitetin.

### **KREU III**

#### **TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E SHFRYTËZUESVE**

##### **Neni 7**

- 7.1. Shfrytëzuesi i bibliotekës ka të drejtën:
  - 7.1.1 E qasjes së lirë në bibliotekë;
  - 7.1.2. Të marrë informacion për koleksionet e bibliotekës dhe koleksionet e bibliotekave të tjera, nëpërmjet mjeteve tradicionale dhe elektronike të informacionit bibliotekar
  - 7.1.3. Të ndihmohet për kërkim dhe zgjedhje të materialit si dhe për të gjetur informacionin që i nevojitet.
  - 7.1.4. Të shfrytëzojë materialin bibliotekar në bibliotekë dhe ta marr në huazim për shfrytëzim jashtë bibliotekës, nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe;
  - 7.1.5. Të merr në huazim material bibliotekar të bibliotekave tjera të huazuar nëpërmjet huazimit ndërbibliotekar të bibliotekës, nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe.
- 7.2. Shfrytëzuesit të cilët përçfardo arsye nuk mund të shfrytëzojnë drejtëpërdrejtë shërbimet e zakonshme të bibliotekës publike (në zonat rurale, në spitale e burgje, të pa- aftët, ata që nuk mund të lëvizin nga shtëpia), kanë të drejtë në shfrytëzim të barabartë të shërbimeve.

##### **Neni 8**

- 8.1. Shërbimet dhe informacionet bibliotekare sigurohen nën kushte të barabarta për të gjithë shfrytëzuesit e bibliotekës.
- 8.2. Shërbimet e huazimit ndërbibliotekar dhe shërbimet e kopjimit e shtypjes, bëhen me pagesë në përputhje me tarifën që e miraton Ministria për Kulturë.

## **Neni 9**

- 9.1. Shfrytëzuesi është i detyruar të përfillë rregullat e mirësjelljes dhe të shfrytëzimit të shërbimeve bibliotekare.
- 9.2. Shfrytëzuesi që shkel rregullat e mirësjelljes e të shërbimeve bibliotekare i nënshtrohet përgjegjësisë kundërvajtëse.
- 9.3. Shfrytëzuesi që i shkakton dëm material bibliotekës, detyrohet për ta kompenzuar atë.

## **KREU IV**

### **PËRGJEGJËSITË DHE AUTORIZIMET E ORGANEVE QENDRORE DHE KOMUNALE**

## **Neni 10**

- 10.1. Organet e qeverisjes komunale dhe qendrore mbështesin dhe nxisin shërbimet bibliotekare dhe sigurojnë kushtet e nevojshme për punën dhe zhvillimin e bibliotekave të sektorit publik që kanë nën përgjegjësi në përputhje me politikën e zhvillimit të kulturës, informacionit, arsimit e edukimit në nivel komunal e kombëtar e të zbatimit të strategjisë për krijimin dhe zhvillimin e rrjetit bibliotekar.
- 10.2. Organet e lartpërmendura bëjnë vlerësimin e shërbimit bibliotekar me qëllim që të rritet qasja dhe të mbështetet zhvillimi i shërbimeve.

## **Neni 11**

### Ministria e Kulturës:

- 11.1. Ushtron aktivitete të administrimit qëndror lidhur me bibliotekat ndërkomunale dhe Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe të bibliotekave që veprojnë në përbërjen e institucioneve që ka nën përgjegjësi;
- 11.2. Nxitë dhe mbështetë aktivitetet e bibliotekave publike për nevojat e diasporës;
- 11.3. Nxitë dhe mbështetë komunat për themelimin dhe zhvillimin e bibliotekave komunale;
- 11.4. Përcakton dhe mbikëqyr funksionimin e rrjetit bibliotekar kombëtar.
- 11.5. Nxjerr akte nënligjore për zbatim të këtij ligji, në konsultim paraprak me Ministrinë e Arsimit.
- 11.6. Mbështet bashkëpunimin ndërbibliotekar ndërkombëtar;

## **Neni 12**

Ministria e Arsimit:

- 12.1. Ushtron aktivitetet e administrimit qëndror lidhur me Bibliotekën Universitare e ato të fakulteteve në kuadër të sistemit të arsimit të organizuar dhe të bibliotekave që veprojnë në përbërjen e institucioneve që ka nën përgjegjësi.
- 12.2. Nxitë dhe mbështetë komunat për themelimin dhe zhvillimin e bibliotekave shkollore në kuadër të sistemit të arsimit të organizuar.

## **Neni 13**

Ministria përkatëse dhe organet komunale sigurojnë mjete nga fondet buxhetore dhe nga fondet tjera publike për nevojat e bibliotekave që kanë nën përgjegjësi dhe ushtrojnë kontrollë për përdorimin efektiv e me përgjegjësi.

## **Neni 14**

14.1. Në Ministrinë Kulturës themelohet Këshilli Kombëtar i Bibliotekave si organ këshillëdhënës i Ministrit.

14.2. Në përbërje të Këshillit hyjnë:

1. Përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës;
2. Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit;
3. Përfaqësuesi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës;
4. Përfaqësuesi i Bibliotekës Universitare;
5. Përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve;
6. Përfaqësuesi i bibliotekave ndërkomunale;
7. Përfaqësuesi i Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës;
8. Përfaqësuesi i Shoqatës së Botuesve të Kosovës.
9. Përfaqësuesi i Univerzitetit;

14.3. Këshilli Kombëtar i Bibliotekave jep mendime, sugjerime dhe propozime për:

- 14.3.1. hartimin e projekteve zhvillimore të bibliotekave;
- 14.3.2. funksionimin e rrjetit bibliotekar dhe të bashkëpunimit ndërbibliotekar;
- 14.3.3. përpilimin dhe mirëmbajtjen e katalogut përmbledhës bibliotekar;
- 14.3.4. kriteret themelore për pasurimin e koleksioneve;
- 14.3.5. kërkesat financiare të bibliotekave;
- 14.3.6. projektet për veprimtarinë e bibliotekave;
- 14.3.7. programin për aftësimin profesional, vendosjen e titujve profesionalë, kushtet dhe procedurën e dhënies së provimit profesional;

14.3.8. raportet vjetore të bibliotekave;

14.3.9. zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Univerzitare të Kosovës dhe të drejtorëve të bibliotekave ndërkomunale.

14.4. Këshilli Kombëtar i Bibliotekave miraton rregulloren për punën e vet.

## **KREU V**

### **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I BIBLIOTEKAVE TE SEKTORIT PUBLIK**

#### **Neni 15**

Organizimi dhe drejtimi i bibliotekave të sektorit publik duhet të synoj rritjen e efektivitetit të punës dhe nivelin e shërbimeve që ofrojnë si dhe arritjen e standardeve dhe rekomandimeve profesionale.

#### **Neni 16**

Autoriteti publik i cili është organ administrativ për bibliotekën si institucion në veti ose për subjektin në përbërjen e të cilit vepron biblioteka, me urdheresë apo me akt tjetër administrativ mund të përcaktoj orientimet dhe kërkesat e ndryshme lidhur me organizimin dhe sferën e veprimit të bibliotekës; me planifikimin e punës e të zhvillimit; me përmbajtjen dhe paraqitjen e raporteve për rezultatet e punës dhe për përdorimin e buxhetit të bibliotekës; organin dhe mënyrën e punësimit, numrin dhe përbërjen e personelit dhe nivelin e llojin e kualifikimeve dhe të aftesive tjera .

#### **Neni 17**

Biblioteka si institucion më veti harton statutin që përmban rregullat e organizimit e të funksionimit të bibliotekës, të cilin e aprovon subjekti themelues.

#### **Neni 18**

Drejtuessi i bibliotekës:

18.1.organizon, bashkërendon dhe mbikqyrë veprimtarinë e bibliotekës dhe përgjigjet për organizimin me efektivitet dhe për realizimin e detyrave dhe të funksionit të saj;

18.2. propozon politikat e zhvillimit të bibliotekës dhe politikat për mbështetje financiare;

18.3.organizon, mbikëqyr dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime e urdhëresa për punë;

18.4. paraqet raportet përkatëse për rezultatet e punës, ecurinë e shërbimeve dhe

përdorimin e buxhetit;

- 18.5. përcjellë problematikën e bibliotekës dhe merr masa për zgjidhje më të mira; si dhe,
- 18.6. ushtron detyra e autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me aktin e emërimit, dispozitat ligjore dhe aktet e tjetra që kanë të bëjnë me bibliotekat

### **Neni 19**

- 19.1. Bibliotekat komunale, ndërkomunale, Biblioteka Kombetare dhe Biblioteka Universitare, themelojnë këshillin e bibliotekës si trup këshilldhënës të bibliotekës, që jep mendime për organizimin, veprimtarinë, shërbimet bibliotekare dhe çështjet e tjera profesionale.
- 19.2. Përbërjen e këshillit të bibliotekës e cakton drejtuesi nga radhët e punonjësve me detyra udhëheqëse e profesionale në bibliotekë, si dhe nga radha e veprimtarëve të kulturës, arsimit e të shkencës jashtë bibliotekës;
- 19.3. Në Këshillin e Bibliotekës Universitare, përfshihen edhe anëtarë nga radha e studentëve.

### **Neni 20**

- 20.1. Biblioteka Kombëtare dhe Biblioteka Universitare ka këshillin mbikëqyrës.
- 20.2. Këshillin mbikëqyrës, në përbërje prej shtatë anëtarësh e emëron Ministria e Kultures, përkatësisht Ministria e Arsimit nga radhët e veprimtarëve të bibliotekonomise, të kulturës, arsimit, arteve dhe të shkencës.
- 20.3. Këshilli mbikëqyrës shqyrton dhe vlerëson realizimin e detyrave e të funksioneve të bibliotekës, efektivitetin e organizimit dhe të punës profesionale, veprimtarinë financiare;
- 20.4. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës emërohen për mandat trevjeçar.
- 20.5. Në seancat e këshillit mbikëqyrës merr pjesë edhe drejtori i bibliotekës
- 20.6. Këshilli mbikëqyrës miraton rregulloren për punën e vet.

## **KREU VI**

### **FUNKSIONET THEMELORE TE BIBLIOTEKAVE TE SEKTORIT PUBLIK**

### **Neni 21**

- 21.1. Bibliotekat publike në kuadër të funksionit të përgjithshëm nga neni 2 i këtij ligji, veçanërisht:

- 21.1.1. sigurojnë koleksione nga të gjitha kategorit e materialeve, në të gjitha formatet e mundshme dhe në sasi të mjaftueshme si dhe informacione për të gjitha llojet e njohurive që reflektojnë drejtimit aktuale dhe zhvillimin e shoqërisë si dhe trashëgiminë krijuese botërore, duke përfshirë edhe atë të komunitetit, me qëllim që shfrytëzuesit të njohin trashëgiminë kulturore, vlerat e artit, arritjet shkencore dhe zhvillimet e reja si dhe të plotësojnë nevojat e tyre për edukim, zhvillim personal, përfshirë edhe çlodhjen e argëtimit;
  - 21.1.2. ruajnë dhe prezantojnë koleksionimin e trashëgimisë kulturore të bashkësisë në të gjithë larminë e saj;
  - 21.1.3. mbledhin informacion rreth komunitetit dhe e bëjnë të përdorshëm, në mënyrë që të ndihmohen qytetarët për të ushtruar të drejtat e tyre demokratike, për t'u njohur me çështjet e aktivitetet themelore në komunitet dhe për vendmarrje të pavarur;
  - 21.1.4. sigurojnë materiale e informacione që mbështesin arsimin e organizuar dhe arsimin individual të shfrytëzuesve të të gjitha moshave dhe që plotësojnë shërbimet e bibliotekave shkollore;
  - 21.1.5. zhvillojnë veprimtari kulturore-sociale e edukuese për popullarizimin e librit dhe nxitjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- 21.2. Ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët në kushte të barabarta dhe pa asnjë dallim, si në bibliotekë edhe në bashkësi; sigurojnë qasje në informacion në të gjitha nivelet dhe trajtojnë shfrytëzuesit e të gjitha moshave në shfrytëzimin e informacionit dhe teknologjisë përkatëse; krijojnë mundësi për të pa aftët që të kenë qasje në mënyrë të pavarur; sigurojnë qasje të barabartë për shfrytëzuesit të cilët, për çfaredo arsye, nuk mund të përdorin shërbimet e zakonshme të bibliotekës (duke organizuar biblioteka lëvizëse për t'u shërbyar atyre që jetojnë në mjedise rurale, shërbime në shtëpi për ata që nuk mund të lëvizin nga shtëpia, shërbime për ata që janë në spitale dhe burje, materiale braile për të verbërit dhe regjistrime zanore për të shurdhërit ).

## **Neni 22**

### **Biblioteka Kombëtare e Kosovës**

- 22.1. Biblioteka Kombëtare e Kosovës është institucioni bibliotekar qëndror i Kosovës, dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar.
- 22.1.a. Biblioteka Kombëtare e Kosovës themelohet me vendim të Kuvendit të Kosovës.
- 22.2. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është nën autoritetin e Ministrisë së Kulturës;
- 22.3. Biblioteka Kombëtare e Kosovës:
  - 22.3.1. është qendër e marrjes dhe e depozitimit të kopjes së detyrueshme;
  - 22.3.2. është qendër e krijimit dhe e mirëmbajtjes së katalogut përmbledhës kombëtar, respektivisht të bazës përmbledhëse kombëtare të të dhëave;
  - 22.3.3. është qendër e studimeve në fushën e bibliotekonomisë, bibliografisë dhe

të informacionit;

- 22.3.4. është qendër e përgatitjes dhe e ofrimit të informacionit bibliografik, bartëse e kontrollit bibliografik në bibliotekat e tjera dhe botuese e bibliografisë kombëtare;
  - 22.3.5. është qendër metodike për zbatimin e standardeve dhe të rekomandimeve të organizatave dhe organizmave përkatës ndërkombëtar në veprimtarinë bibliotekare dhe të informacionit bibliotekar;
  - 22.3.6. është qendër për restaurimin dhe konservimin e librit;
  - 22.3.7. është qendër për koordinimin e rrjetit kombëtar bibliotekar;
  - 22.3.8. vepron si qendër e huazimit ndërbibliotekar;
  - 22.3.9. katalogon publikacionin e përgatitur për botim (CIP) dhe bënë pajisjen e publikacioneve me numrat standard ndërkombëtarë (ISBN dhe ISMN) të botuesve në Kosovë;
  - 22.3.10. Zhvillon programe për trajnimin dhe aftësimin profesional e të vazhdueshëm të punonjësve bibliotekar;
  - 22.3.11. plotëson shërbimet e bibliotekave ndërkomunale dhe të Bibliotekës Universitare ;
  - 22.3.12. ushtron mbikëqyrjen profesionale ndaj të gjitha bibliotekave;
- 22.4. Biblioteka Kombëtare e Kosovës anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare dhe merr pjesë në aktivitete bibliotekare ndërkombëtare.
- 22.4.1 Selia e Bibliotekës Kombëtare është në Prishtinë.

## **Neni 23**

### **Bibliotekat komunale dhe ndërkomunale**

- 23.1. Biblioteka ndërkomunale koordinon bashkëpunimin e dy ose më shumë bibliotekave komunale, ndihmon dhe plotëson veprimtarinë e tyre me koleksione, huazime, falje të materialeve bibliotekar dhe në shërbime të veçanta për shfrytëzuesit që nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë shërbimet e zakonshme.
- 23.2. Ministria e Kulturës themelon me vendim të veçantë bibliotekat ndërkomunale.
- 23.3. Ministria e Kulturës, në marrëveshje me organet përkatëse komunale, cakton bibliotekën që do të kryej funksionin e bibliotekës ndërkomunale.

## **Neni 24**

- 24.1. Biblioteka komunale krijohet në çdo komunë, si bibliotekë e bashkësisë në tërësi.

24.2. Bibliotekat komunale mund të themelojnë degët e tyre në lokalitete sipas kërkesave dhe mundësive buxhetore.

## **Neni 25**

### **Biblioteka Universitare**

- 25.1. Biblioteka Universitare është bibliotekë qendrore e Universitetit të Prishtinës.
- 25.2. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Universitare është nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit në bashkëpunim me Universitetin.
- 25.3. Biblioteka Universitare siguron materiale, informacione dhe shërbime bibliotekare që ndihmojnë veprimtarinë akademike e shkencore si dhe procesin e edukimit shkencor e artistik në Universitet dhe zhvillimin e aftësive të studentëve dhe mësimeve të tyre;
- 25.4. Ndihmon studentet që ndjekin studimet në distancë duke iu dhënë në huazim materiale bibliotekare dhe duke siguruar qasje në burimet elektronike të informacionit.
- 25.5. Plotëson shërbimet e bibliotekave të fakulteteve në përberjen e Universitetit.
- 25.6. Selia e Bibliotekës së Universitetit është në Prishtinë.

## **Neni 26**

Bibliotekat e Institucioneve të shkollimit të lartë janë degë të Bibliotekës Universitare dhe sigurojnë materiale, informacione e shërbime bibliotekare që ndihmojnë procesin e edukimit shkencor e artistik që ofron fakulteti si dhe zhvillimin e aftësive të studentëve dhe të mësimeve të tyre; ndihmon studentët që ndjekin studimet në distancë duke iu dhënë në huazim materiale bibliotekare dhe duke siguruar qasje në burimet elektronike të informacionit.

## **Neni 27**

### **Bibliotekat shkollore**

- 27.1. Biblioteka shkollore vepron pranë institucionit arsimor përkatës.
- 27.2. Biblioteka shkollore siguron materiale, informacione e shërbime bibliotekare në funksion të edukimit që ofron shkolla dhe të zhvillimit të aftësive të nxënësve dhe të mësimeve të tyre.

## **Neni 28**

### **Bibliotekat e veçanta**

Bibliotekat e veçanta sigurojnë materiale, shërbime e informacione bibliotekare të llojit të veçant të njohurive ose me tematikë e veçantë që i plotësojnë nevojat specifike të shfrytëzuesve dhe ndihmojnë e mbështesin aktivitetet e institucionit në përbërje të të cilit veprojnë.

## KREU VII

### VEPRIMTARIA BIBLIOTEKARE

#### Neni 29

29.1. Veprimtaria bibliotekare përfshinë:

29.1.1. grumbullimin e materialit bibliotekar të formateve të ndryshme, regjistrimin, përpunimin dhe sistemimin e tij në koleksione, ruajtjen, riparimin dhe vënien e koleksioneve në shërbim të shfrytëzuesve ;

29.1.2. grumbullimin, përpunimin dhe ofrimin e informacioneve që kanë të bëjnë me materialin bibliotekar;

29.2. Në shërbime bibliotekare përfshihen: dhënia e librave dhe materialeve tjera për shërbim në bibliotekë; shërbimet informuese duke përdorur median e shtypur dhe atë elektronike; shërbimet orientuese dhe referative për të gjetur informacionin, përkatesisht burimin e informacionit të kërkuar; shërbime për të ndihmuar shfrytëzuesit në shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.

29.3. Në material bibliotekar, përfshihen:

botimet e veprave dhe të materialeve të shtypura e grafike, siç janë librat dhe tekstet e tjera, broshurat, revistat, gazetat, publikimet zyrtare, riprodhimet e veprave të artit vizuel, riprodhimet e veprave kartografike, riprodhimet e planeve urbanistike; veprat muzikore, materialet e reprografuara, pllakatat, afishet, fonodokumentet, fotodokumentet, regjistrimet pamore e filmike, veprat tjera të reprodukuara me anë të shtypit ose në një mënyrë tjetër, dorëshkrimet (duke nënkuptuar edhe magjistraturat dhe doktoratet ), fotokopjet dhe materialet e memorizuara.

29.4. Përpilimin e regjistrit të librave të humbur për plotësimin e tyre me fotokopje.

#### Neni 30

30.1. Materiali bibliotekar burimor (dorëshkrime, i shtypur ose i krijuar në ndonjë formë tjetër), që ka vlerë dokumentare për kulturën, artin dhe shkencën, (libri i rrallë apo unikat, materiali i vjetër, kopia e detyrueshme e publikacionit), sistemohet në koleksion të trashëgimisë dokumentare kulturore dhe konsiderohet pjesë e thesarit kulturor kombëtar; ruhet e mbrohet në përputhje me dispozita të veçanta që vlejné për trashëgiminë kulturore; shfrytëzohet vetëm në mjediset e bibliotekës, përkatësisht nuk jepet në huazim.

30.2. Nxjerrja jashtë Kosovës e materialit bibliotekar burimor , lejohet vetëm në formë të reprodukuar, në funksion të bashkëpunimit kulturor e shkencor ndërkombëtar në bazë të vendimit të Ministrit për Kulturë dhe Ministrit për Shkencë.

#### Neni 31

31.1 Bibliotekat krijojnë dhe pasurojnë koleksionet në përputhje me llojin e bibliotekës dhe funksionin që kanë, si dhe me nevojat e atyre që u shërbejnë.

31.2 Krijimi dhe pasurimi i koleksioneve, sa i përket vëllimit dhe strukturës, zhvillohet në bazë të kriterëve profesionale për sigurimin dhe prezantimin e materialit bibliotekar që përmban informacione dhe njohuri nga krijimtaria letrare, artistike e shkencore në nivel vendor e botëror, të parimit të respektimit të të drejtave civile, politike e kulturore të të gjithë qytetarëve dhe të parimit të grumbullimit dhe prezantimit të materialit bibliotekar me veprat nëpërmjet të cilave shprehet, afirmohet dhe zhvillohet identiteti kulturor, etnik e gjuhësor dhe vlerat demokratike.

### **Neni 32**

- 32.1. Materiali Bibliotekar nuk lejohet të dëmtohet, të tjetersohet dhe as të asgjësohet, nëse me këtë ligj apo aktet nënligjore nuk përcaktohet ndryshe.
- 32.2. Materiali bibliotekar ruhet në mjediset ku është i mbrojtur nga zjarri, lagështira dhe nga shkaktarët tjerë fizik, biologjik e kimik që do të mund ta dëmtonin ose shkatërronin.
- 32.3. Mirëmbajtja e koleksioneve zbatohet për të gjitha materialet pavarësisht nga formati
- 32.4. Përpunimi i materialit bibliotekar kryhet në mënyrë të njësuar duke zbatuar standardet e caktuara ndërkombëtare dhe kombëtare.
- 32.5. Çdo bibliotekë mbanë librin e inventarit, katalogun alfabetik dhe katalogje tjera për materialin bibliotekar.
- 32.6. Revizioni dhe çregjistrimi i materialit bibliotekar kryhet së paku një herë në dhjetë vjetë.
- 32.7. Ministri i Kulturës nxjerr rregullore të veçanta lidhur me evidentimin, ruajtjen dhe mbrojtjen, përpunimin dhe revizionin e çregjistrimin e materialit bibliotekar.
- 32.8. Te gjitha bibliotekat i bëjnë të mundshëm ushtrimin e kontrollit ndaj punës profesionale punëtorit të autorizuar të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe veprojnë sipas urdheresës së dhënë lidhur me mbikëqyrjen profesionale.

### **Neni 33**

Materialet bibliotekare të huazuara nga bibliotekat tjera nëpërmjet të huazimit ndërkombëtar, jepen në shfrytëzim vetëm në mjedisin e bibliotekës.

### **Neni 34**

Koleksionet e bibliotekës të sektorit publik e cila pushon së funksionuari, detyrimisht regjistrohen dhe i vehen në dispozicion Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, e cila i sistemon në koleksionet e veta ose ua shpërndan bibliotekave tjera.

### **Neni 35**

Të gjitha bibliotekat kanë për detyrë t'ia dërgojnë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës informacionet bibliografike dhe të dhënat e tjera të nevojshme për mbajtjen e katalogut përmbledhës dhe për ushtrimin e funksioneve tjera.

### **Neni 36**

Bibliotekat krijojnë marrëdhënie shkëmbimi e huazimi ndërkombëtar me bibliotekat homologe në përputhje me standardet e normat e bashkëpunimit ndërkombëtar bibliotekar.

### **Neni 37**

- 37.1. Çdo bibliotekë harton rregulloren e saj, e cila përmban rregullat e shfrytëzimit të bibliotekës dhe të drejtat dhe detyrat e shfrytëzuesve.
- 37.2. Punët profesionale dhe kushtet për kryerjen e tyre, titujt profesional dhe programin e provimit profesional dhe mënyrën për dhënien e tij, i përcakton me rregullore të veçantë Ministri i Kulturës.

## **KREU VIII**

### **FINANCIMI**

### **Neni 38**

- 38.1. Bibliotekat e sektorit publik financohen nga fondet buxhetore dhe fondet tjera publike.
- 38.2. Bibliotekat e sektorit publik mund të përfitojnë të ardhura edhe nga burimet e tjera si donacione nga fondacionet, organizatat joqeveritare vendase dhe të huaja etj., si dhe nga shërbimet që ushtrojnë me pagesë; këto të ardhura, biblioteka ia bën të njohur autoritetit kompetent publik dhe mund të shfrytëzohen për pasurimin e koleksioneve për mirevajtjen dhe zhvillimin e bibliotekës.
- 38.3. Bibliotekat tjera financohen nga themeluesi dhe nga burimet e tjera financiare në kuptim të paragrafit të sipërm.

## **KREU IX**

### **DISPOZITA TJERA**

### **Neni 39**

- 39.1. Çdo person ose subjekt që boton publikacione në Kosovë që i dedikohen shfrytëzimit publik, detyrohet që pesë kopje të çdo botimi t'ia dërgojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e botimit; e nëse botuesi nuk është i identifikuar ose është i identifikuar rrejshëm (i panjohur), përkatësisht nuk ka vendqëndrim ose seli në Kosovë, këtë detyrim do ta kryejë shtypshkronja, përkatësisht subjekti që ka bërë riprodhimin.

39.2. Si botim konsiderohen librat si dhe librat me disk gramafoni, me kasete audiovizuale, me harte gjeografike e shtojca të ngjashme (botimet multimediale), broshurat, separatet, revistat, gazetatat, riprodhimet artistike, veprat muzikore të shkruara në partitura, hartat gjeografike, atlasat, globuset e të gjitha llojeve, planet urbanistike, pllakatat, katalogjet, programet, kartolinat dhe fotografitë e shtypura, diapozitivat etj. si dhe pjesët e tyre përbërese a shoqëruese të riprodhuara në mënyrë grafike, disqet e gramafonit dhe kompakt disqet, kasetat audio dhe vizuale të regjistruara, disketat kompjuterike të regjistruara dhe veprat tjera që riprodhohen me shtypshkrim ose në një mënyrë tjetër të ngjashme.

## **Neni 40**

40.1. Çdo person në Kosovë që posedon material bibliotekar me rëndësi të veçantë për kulturën duhet:

40.1.1. ta informojë Bibliotekën Kombëtare të Kosovës për evidentimin e materialit;

40.1.2. t'i mundësojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës hulumtime të mëtejshme shkencore dhe, kur është e nevojshme edhe konservimin ose restaurimin e tij sipas marrëveshjes me poseduesin;

40.1.3. t'i ofrojë paraprakisht Bibliotekës Kombëtare të Kosovës blerjen e materialit të tillë, nëse ka për synim tjetërsimin e tij ;

40.2. Personi që posedon material të tillë ka të drejtë të kërkojë nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës shërbim falas për restaurimin ose konservimin e tij.

## **KREU X**

### **DISPOZITA NDËSHKIMORE**

#### **Neni 41**

41.1. Me gjobë prej 100 - 1000 € dënohet për kundërvajtje shfrytëzuesi që e dëmton, tjetëron, nuk e këthen ose e asgjëson materialin bibliotekar ose në ndonjë mënyrë tjetër shkel rregullat e shfrytëzimit të bibliotekës (neni 32.1. dhe 9.2.),

41.2. Me gjobë prej 200 - 500 € dënohet për kundërvajtje drejtuesi i bibliotekës, nëse nuk ia dërgon Bibliotekës Kombëtare të Kosovës të dhënat e duhura (neni 35);

41.3. Me gjobë prej 200 - 1000 € dënohet për kundërvajtje botuesi, përkatësisht subjekti që nuk kryen obligimin e dërgimit të kopjes së detyrueshme në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ( neni 39.1.);

41.4. Me gjobë prej 200 - 1200 € dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës i cili nuk ia dërgon Bibliotekës Kombëtare të Kosovës koleksionin e bibliotekës të sektorit publik që ka pushuar së funksionuari ( neni 34);

41.5. Me gjobë prej 200 -1 200 € dënohet për kundërvajtje drejtuesi i bibliotekës, që nuk vepron në kuptim të funksionimit të njetit bibliotekar të Kosovës ( neni 6.1.);

- 41.6. Me gjobë prej 100 - 200 € dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës bibliotekar që nuk vepron ose refuzon restaurimin e materialit bibliotekar me vlerë dokumentare kulturore sipas kërkesën së poseduesit për një shërbim të tillë ( neni 40.2 .);
- 41.7. Me gjobë prej 100 - 300 € dënohet për kundërvajtje shfrytëzuesi që prishë rendin ose rregullat e mirësjelljes në bibliotekë (neni 9.2.).
- 41.8. Me gjobë prej 200 - 900 € dënohet për kundërvajtje punëtori i bibliotekës që cenon të drejtën e shfrytëzuesit për shërbim ( neni 7.1.1); ose për qasje të lirë, ose të drejtën e kërkimit dhe të marrjes së informacionit (neni 2.3.).
- 41.9. Me gjobë prej 200-2000 € dënohet për kundërvajtje drejtuesi i bibliotekës që nuk vepron në kuptim të nenit 32.2. – 32.6.
- 41.10. Me gjobë prej 100-600 € dënohet për kundërvajtje drejtuesi i bibliotekës që nuk vepron sipas urdhëresës së dhënë nga personi zyrtar lidhur me kontrollin profesional (neni 32.8.).
- 41.11. Me gjobë prej 100-1000 € dënohet për kundërvajtje punëtori bibliotekar që jep në huazim jashtë bibliotekës materialin në kuptim të nenit 33 ose në kundërshtim me nenin 30.1.
- 41.12. Me gjobë prej 100-900 €, dënohet për kundërvajtje drejtuesi apo personi zyrtar i bibliotekës që fillon punën pa bërë regjistrimin ose që nuk i paraqet të dhënat për mbajtjen e regjistrit të bibliotekave sipas rregullores nga neni 4.10.
- 41.13. Masat ndëshkuese nga ky nen, sipas fletë paraqitjes së bibliotekës përkatëse, në përputhje me ligj në procedurë të rregulltë i përcakton gjykata kompetente.

## **KREU XI**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE E TË FUNDIT**

#### **Neni 42**

- 42.1. Ministria e Kulturës do të nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- 42.2. Bibliotekat do të harmonizojnë organizimin dhe veprimtarinë brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
- 42.3. Bibliotekat e tanishme rajonale riorganizohen si biblioteka ndërkomunale në afat prej gjashtë muajsh.
- 42.4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë së vepruari ligjet e mëparshme mbi veprimtarinë bibliotekare.

#### **Neni 43**

- 43.1. Ky ligj shpallet në tekstin identik në gjuhën shqipe, serbishte dhe anglishte.

43.2. Ne rast të mospërputhjes, si tekst burimor për nevojat e interpretimit, do të konsiderohet teksti në gjuhën angleze.

#### **Neni 44**

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi, me nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji nr.2003 / 6**  
**04 Prill 2003**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës ,**  
-----  
**Akademik Nexhat Daci**